



Arjan Gjonca është profesor i demografisë në London School of Economics. Ai ka një doktoraturë në ekonomi (demografi) nga LSE dhe vazhdon të punojë në Departamentin e Politikave Sociale në LSE. Dr. Gjonça filloi karrierën e tij si asistent profesor në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Përvoja e tij përfshin institucione të tilla si Instituti Max Planck për Kërkimin Demografik; Universiteti i Southampton, Departamenti i Statistikave Sociale; Universiteti Bocconi, Qendra e Kërkimeve për Dinamikën Sociale dhe Politikën Publike (profesor vizitor), dhe më në fund Departamenti i Politikës Sociale në LSE. Interesat e tij kërkimore dhe publikimet përqëndrohen në shëndetin dhe

vdekshmërinë në vendet në zhvillim.

Ai është anëtar i organeve të ndryshme profesionale, duke përfshirë International Union for the Scientific Study of Population, British Society for Population Studies (BSPS), European Association for Population Studies, Population Association of America dhe shumë të tjera. Ai ka mbajtur dhe vazhdon të mbajë poste të nderit, siç është Sekretari Nderi i BSPS nga 2001-2004, dhe anëtar i këshillit nga 1997 deri 2004; Nënkryetar i Shoqatës DemoBalk etj.

Dr. Gjonça ka vepruar si këshilltar i organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe qeverive kombëtare, përfshirë Bankën Botërore, UNFPA, UNDP, Qeverinë Shqiptare, Qeverinë Turke dhe Qeverinë Boshnjake. Kontributi i tij i fundit përfshin kryesimin e Komisionit për Reformën e Arsimit të Lartë në Shqipëri (2013-2015), i cili u finalizua me futjen e legjislacionit të ri për arsimin e lartë në vend. Që nga viti 2015 ai mban postin e Kryetarit të Bordit të Akreditimit (ish Këshilli) i Shqipërisë.